



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 204/5 Prot.
2023

Tiranë, më 31 . 07 .

V E N D I M

Nr. 147., Datë 31 . 07 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 21 Regj., datë 06.02.2023, paraqitur nga subjekti ankues, Qendra “Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri³”, kundër Kinemasë “Millenium” Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*identitetit gjinor*” dhe “*orientimit seksual*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së sjellë pranë KMD-së, subjekti ankues, Qendra “Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, ka parashtruar se, me datë 24.11.2022, Kinema “Millenium” Tiranë ka anuluar vetëm pak minuta para shfaqjes së njoftuar zyrtarisht në kanalet e saj të komunikimit (Web, profilet zyrtare në Facebook dhe Instagram), filmin “Strange World” ose “Botë e Mrekullueshme”.

Subjekti ankues shprehet se, ndërkohë që u komunikua anulimi i shfaqjes së filmit, jashtë ambienteve të Kinema “Millenium” Tiranë, po zhvillohej aksioni i Koalicionit “Pro Jetës dhe

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive e Qendrës, Alba Ahmetaj.

Familjes”. Gjatë këtij takimi, Qendra ka pretenduar se nga z. A. G është shprehur se i jepnin 24 orë kohë (Kinemasë) që nëse nuk do të anulonte shfaqjen e këtij filmi, Kinemaja do të bojkotohej pa afat. Pra, synimi i këtij takimi ishte ndikimi tek Kinemaja me qëllim anulimin e shfaqjes së filmit, pasi z. Goxhaj u shpreh se shfaqja e tij ishte një “kurth”, pasi Kinemaja nuk u ofronte prindërve të fëmijëve informacion mbi përmbajtjen homoseksuale të filmit, përmbajtje e cila sipas tij, mund të dëmtonte shëndetin mendor, emocional dhe të ndikonte negativisht në shumë fëmijë.

Bazuar në sa më sipër, Qendra “Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, është shprehur se ka krijuar dyshimin e arsyeshëm, bazuar në thirrjet e Koalicionit “Pro Jetës dhe Familjes” se fjalët e tyre mund të kenë qenë të asaj natyre e atij intensiteti sa mund të kenë ndikuar në marrjen e vendimit diskriminues ndaj komunitetit LGBTI+, nga Kinema “Millenium” Tiranë, pasi ekzistojnë disa thirrje e një kërkesë publike kundrejt Kinemasë, për të mos shfaqur filmin “Strange World”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të personave të komunitetit LGBT, nga ana e Kinema “Millenium” Tiranë, për shkak të “orientimit seksual” dhe të “identitetit gjinor”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 722, datë 01.03.2012, nëpërmjet së cilit Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”, është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të komunitetit LGBT në Shqipëri.

Mbështetur në përmbajtjen e aktit e regjistrimit dhe Statutin e Qendrës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

“- Të mbrojtë të drejtat e çdo personi LGBT në Shqipëri;

- Të llobojë dhe advokojë për dhe në emër të komunitetit LGBT në Shqipëri;
- Të informojë institucionet shtetërore, Qeverinë shqiptare, publikun e gjerë, komunitetin LGBT dhe organizatat ndërkombëtare për situatën e të drejtave të komunitetit LGBT në vend;
- Të ndërgjegjësojë institucionet shtetërore, Qeverinë shqiptare, publikun e gjerë dhe familjet për respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT;
- Të asistojë komunitetin LGBT dhe të vendosë në dispozicion të tyre mjete, që bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së këtij komuniteti në jetën publike të vendit dhe në vendimmarrje, në nivel qendror dhe lokal;
- Të bashkëpunojë me organizat brenda dhe jashtë Shqipërisë për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri;
- Të punonjë për përmirësimin e legjislacionit, politikave dhe standardeve për të drejtat e personave LGBT në Shqipëri;
-
- Të promovojë respektimin e Konventave dhe akteve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës etj, që mbrojnë e garantojnë të drejtat e personave LGBT, të drejtat e njeriut, të grave, të minoriteteve etj”.

Qëllimi kryesor i Qendrës, sipas parashikimit të bërë në nenin 3, të Statutit, është të mbrojtë dhe të promovojë respektin për të drejtat e homoseksualëve, lesbikeve, biseksualëve dhe transeksualëve.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 722/4, datë 29.12.2022, znj. A. A është zgjedhur Drejtore Ekzekutive e Qendrës, e cila bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 14, të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Qendrës në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e komunitetit LGBT. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Qendra, përfaqësuar nga A. A (Drejtore

Ekzekutiv) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBT.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 204/1 prot., datë 10.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Kinema Millenium, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
 2. Në mungesë të përgjigjes zyrtare brenda afateve ligjore (LMD), nëpërmjet shkresës me nr. 204/2 prot., datë 29.03.2023, Komisioneri sërish ka kërkuar parashtrime dhe informacion nga ana e Kinema “Millenium”, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Në vijim, nëpërmjet shkresës protokolluar pranë KMD-së me nr. 204/3 prot, datë 07.04.2023, Kinema “Millenium”, ka njohur Komisionerin me qëndrimin përse i takon pretendimeve të subjektit ankues, duke parashtruar si më poshtë vijon:

“Së pari, filmat që shfaqen në kinema “Millenium” zgjidhen në bazë të listave që dërgojnë distributorët. Kinema “Millenium” ka shfaqur filma pro komunitetit LGBT, pa asnjë lloj diskriminimi, si filmi “Blue is the warmest color”, etj.

Në shumë raste ndodhin anulime titujsh, në sajë të rezervimeve të sallës nga të tretë, në periudhën që është anoncuar për filmin, si psh: festivale filmi, ditë të filmave të ambasadave të ndryshme të vednit, rezervime shkollsh dhe nxënësish, etj.

Së dyti, filmi ka qenë në listë dhe nuk është shfaqur për faktin e vetëm se ka përkuar me filma për të cilët ka patur më shumë kërkesa. Duke patur vetëm një sallë kinemaje, klientët kanë rezervuar filma të cilët kanë qenë në transmetim duke dashur vazhdimin e tyre në kohë, dhe si rrjedhim është anuluar titulli i ardhshëm. Kjo ka qenë arsyeja e vetme, pa pasur asnjë qëllim diskriminimi apo të ndonjë natyre tjetër.

Së treti, filmi nuk është blerë nga Kinemaja dhe për këtë arsye nuk ekziston një kontratë blerje për këtë film.

Së katërti, filmi “Strange World” mund të shfaqet në çdo moment nëse palët e interesuara mund të blejnë apo sponsorizojnë filmin.

Së pesti, filma të tjerë të anuluar ose të shtyrë janë edhe:

- “Fableman”
- “Babylon”
- Ndërsa “Era e Jugut” është anuluar.

Së fundmi, përse ka pretenduar subjekti ankues, ju bëjmë me dije se, Kinema “Millenium” nuk ka patur asnjë qëllim diskriminimi për shkak të identitetit gjinor apo orientimit seksual, por, çka ka ndodhur ka qenë veçse e lidhur me anën teknike të punës e për më tepër, respekti dhe mbështetja për komunitetin LGBT në Shqipëri ka qenë e do të mbetet maksimale”.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 204/4 prot., datë 28.04.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 17.05.2023, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e përfaqësueseve të palës ankuese: A. A, Drejtore Ekzekutive e Qendrës dhe av. S. K, me numër licence, 10 419, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe përfaqësuesit të palës kundër të cilës është paraqitur ankesa, av. E. M, me numër licence 8713, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, sipas Autorizimit të datës 17.05.2023, të Shoqërisë “Joni 5” sh.p.k.

Në deklaratimet e bëra gjatë seancës, të dyja palët mbajtën të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit.

Përfaqësueset e palës ankuese, gjatë parashtrimeve, në pretendim të faktit se shfaqja e anuluar nga Kinema “Millenium” ishte nxitur nga protesta e organizuar nga i ashtëquajtori “Koalicioni pro Jetës dhe Familjes”, theksuan se, kishte patur një numër i madh prenotimesh të bëra nga anëtarë të komunitetit LGBT, *on line* apo *fizikisht në sportel*, për filmin “Strange World”, të cilët ishin paraqitur me datë 24.11.2022, pranë Kinemasë për të vijuar me ndjekjen e tij. Ata pretenduan se shfaqja e filmit ishte anuluar menjëherë pas aksionit të ndërmarra nga grupimi i udhëhequr nga A. G dhe A. P.

Në parashtrimet e bëra në emër të Kinemasë⁴, theksohet fakti që, anulimi i shfaqjes nuk ka lidhje fare me sa ka pretenduar pala ankuese, pasi lidhet vetëm me interesat tregtare të Kinemasë, duke qenë se nuk ka pasur mjaftueshëm interes për këtë film, gjë që kushtëzohej edhe nga pasja në dispozicion e vetëm një salle.

Përfaqësuesi i Kinemasë, mbajti qëndrimin se, përkimi i anulimit të shfaqjes së filmit, me aksionin e të ashtëquajturit “Koalicioni pro Jetës dhe Familjes”, përbën tërësisht një rastësi, duke cituar se:

“Nga leximi i pretendimeve të palës ankuese, duket sikur Kinemaja është udhëzuar për të diskriminuar, në kuptim të nenit 3/6, të LMD-së, në një kohë që kjo nuk mund të jetë e vërtetë, pasi nuk ekziston asnjë marrëdhënie hierarkie ndërmjet këtij të ashtëquajturit “Koalicion Pro Jetës dhe Familjes” dhe Kinemasë “Millenium”.

Vendimet e Kinemasë udhëhiqen vetëm nga interesa tregtare dhe këtë e tregon fakti se, siç kemi shpjeguar, kjo Kinema ka shfaqur edhe filma të tjerë të ngjashëm si: “Blue is the warmest color”, etj. Ky nuk është anulimi i parë i një shfaqje filmi, pasi të tilla anulime apo shtyrje ndodhin rëndom, në varësi të kushteve apo kërkesave, siç dhe kemi shpjeguar. Kinema “Millenium” për asnjë çast nuk ka fshehur apo transformuar shkaqet e anulimit të shfaqjes. Në këtë kuptim nuk qëndron as pretendimi i palës ankuese për diskriminim, pasi anulimi i shfaqjes së filmit përbën një masë që justifikohet nga një synim plotësisht i ligjshëm, siç është fitimi tregtar”.

⁴ Depozituar me edhe me shkrim pranë KMD-së, gjatë seancës.

Në mbyllje të seancës, palëve iu bë i ditur fakti se, bazuar në nenin 33, pikën 9, të tij, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*, nëse ata do të dakordësoheshin ndërmjet tyre për të arritur një marrëveshje me mirëkuptim, duhet të informonin Komisionerin brenda një afati 10 ditor nga zhvillimi i seancës. Palëve iu bë i ditur fakti, se në rast të mos arritjes së dakordësisë mes palëve, Komisioneri do të vijonte me shqyrtimin e ankesës në themel.

4. Njëpërmjet komunikimit me email, në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës, përfaqësuesi i Kinemasë, ka theksuar qëndrimin e mbajtur, si më poshtë vijon:

“Filmi “Strange World”, mund të shfaqet në çdo moment nëse palët e interesuara mund të blejnë apo sponsorizojnë filmin.

Po ashtu, anulimi i filmit është nxitur vetëm nga qëllimet tregtare të Shoqërisë, nisur nga mungesa e interesit ekonomik.

Pasi KMD, la afat për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes mes palëve, nga ana e palës ankuese nuk ka pasur kërkesa për shfaqjen e filmit, kundrejt blerjes apo sponsorizimit të tij. Në këtë kuptim, Kinema “Millenium” nuk ka pasur se çfarë masash apo negociatash të ndërmarrë”.

5. Komisioneri, njëpërmjet emailit të datës 13.06.2023, iu drejtua palës ankuese, duke e njohur me përgjigjen e mësipërme të Kinemasë, si dhe lidhur me kërkesën e KMD-së për të dërguar, fakte e prova, të cilat do të provonin interesin e shprehur nga personat, pjesë e komunitetit LGBT (*sikurse u pranua prej tyre në seancë*), që mund të ishin, prenotime të bëra online apo biletat e rezervuara, njëpërmjet të cilave të provohej interesi për ndërkuptimin e filmit “Strange World”.

Në mungesë të arritjes së një dakordësie apo zgjidhjeje me mirëkuptim mes palëve, Komisioneri vijoi procedurën e shqyrtimit të ankesës së depozituar, si më poshtë vijon:

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Nga këqyrja e analizimi i fakteve, provave e parashtrimeve të depozituara nga palët, evidentohet se:

Në datën 24.11.2022, Kinema Millenium ka anuluar rreth 30 minuta para shfaqjes së njoftuar zyrtarisht në kanalet e saj të komunikimit (*Web dhe profilet zyrtare të saj në Facebook dhe Instagram*) shfaqjen e filmit “Strange World”.

Lidhur me anulimin e shfaqjes së filmit, pala ankuese ka pretenduar se mund të jetë nxitur nga thirrjet e bëra në rrjetet sociale të të ashtëquajturit “Koalicioni pro Jetës dhe Familjes”, të udhëhequr nga pastori A. P dhe aktivisti A. G, si dhe në mbledhjen e mbajtur prej tyre me

datë 23.11.2022, të cilët ishin shprehur se filmi që do të shfaqej ishte një kurth, pasi Kinemaja nuk u ofronte informacione prindërve mbi përmbajtjen e tij homoseksuale.

Komisioneri, evidenton faktin se, pretendimet e përfaqësueseve të komunitetit LGBT, lidhur me gjuhën e urrejtjes të përdorur nga i ashtëquajtori “Koalicioni pro Jetës dhe Familjes”, janë bërë objekt shqyrtimi në kuadër të një ankese tjetër, të regjistruar pranë KMD-së, dhe në këtë kontekst, analizimi i tyre i përket një vendimmarrjeje tjetër, dhe jo në kuadër të kësaj ankese.

Për rrjedhojë, Komisioneri, në këtë vendim, do të analizojë vetëm veprimet apo mosveprimet e Kinemasë në kuadër të pretendimit të subjektit ankues, lidhur me anulimin e shfaqjes së filmit “Strange World”, pa u ndalur në elementë të veçantë të përmbajtjes së tij.

Pala ankuese ka deklaruar se rreth orës 10:30, disa aktivistë të Aleancës LGBT, i janë drejtuar ambienteve të Kinemasë për të ndjekur këtë film.

Pasi janë paraqitur për ndjekjen e filmit pranë Kinemasë, në recepsion u është komunikuar se shfaqja e filmit “Strange World”, është anuluar.

Pala ankuese, qëndrimin e Kinemasë lidhur me anulimin e shfaqjes së filmit, e ka dëshmuar nëpërmjet një komunikimi me whatsapp të një përfaqësueseje të komunitetit LGBT (znj. XH. K) dhe znj. E. B, e cila përgjigjet në emër të Kinemasë. Në komunikimin ndërmjet tyre evidentohet se, znj. E. B, ndër të tjera shprehet se:

“Kinema “Millenium” nuk ka fare probleme të këtij lloji. Kemi shfaqur sistematikisht filma pro LGBT. Ne thjesht kemi një sallë dhe shumë tituj, e shpesh anullojmë shfaqje për t’u lënë hapësirë filmave që kanë më shumë interes.

...filmi nuk do të shfaqet se fëmijët/shkollat kanë zgjedhur titull tjetër...

...nuk e kemi marrë për distribuim sepse zgjodhëm të vazhdojë E Wakamba, që ka më shumë interes...”

Lidhur me komunikimin e mësipërm, pavarësisht faktit se, nuk është në formën e “provës” apo “dokumentimit të saj në formën e kërkuar nga ligji”, Komisioneri vëren se, përsa kohë nuk u kundërshtua si i pabazuar apo i paqenë, nga përfaqësuesi i Kinemasë mund të merret i mirëqenë, në kuadrin e një prove rrethore.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, qëndrimi i E. B do të konsiderohet si një dëshmi në harmoni edhe në koherencë me qëndrimin e parashtrimet e tjera të depozituara në vijim nga ana e Kinemasë.

Pala ankuese ka pretenduar për shkelje të parimit të mosdiskriminimit nga ana e Kinemasë, kundrejt komunitetit LGBT, lidhur me anulimin e shfaqjes së filmit “Strange World”, për shkak të orientimit e identitetit gjinor të tyre.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri, vlerëson se, si në parim, si në praktikën e krijuar nga KMD, lidhur me çështjet e trajtuara, fillimisht, i takon palës që pretendon diskriminimin, të krijojë një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), në mënyrë që barra e

provës, më pas të kalojë tek subjekti, i cili duhet të tregojë se sjellja, veprimet apo mosveprimet e tij nuk janë diskriminuese.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person apo grup personash posedojnë këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Subjekti i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, *por jo vetëm*, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun/shkaqet e mbrojtur/a, që në çështjen objekt shqyrtimi janë orientimi dhe identiteti seksual.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të Kinemasë kundër komunitetit LGBT, që të jenë motivuar nga identiteti apo orinetimi seksual i tyre. Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se:

- Pala ankuese, e cila duhet të krijonte *a prima facie*, prezumimin për diskriminim, nuk solli asnjë provë apo dokumentoi në një formë tjetër, se sa ishte konkretisht numri i biletave të rezervuara apo prenotuara (*qoftë online, qoftë fizikisht - në sportelin e Kinemasë*) nga anëtarë të komunitetit LGBT, gjë për të cilën përfaqësueset e saj u deklaruan se do t'i depozitonin si provë pranë Komisionerit;
- Në mungesë të provave nga pala ankuese, lidhur me interesin e shprehur prej tyre, për ndjekjen e filmit “Strange World”, Komisioneri merr të mirëqenë deklarin e Kinemasë, e cila ka vlerësuar se nuk ka pasur mjaftueshëm interes të shprehur për këtë film, duke u nisur edhe nga fakti se Kinemaja – si një subjekt privat tregtar, ka prioritet interesin e saj tregtar dhe të ardhurat e gjeneruara nga ky biznes;
- Komisioneri konsideron faktin se nga ana e Kinemasë, (*fakt i pakundërshtuar edhe nga pala ankuese*) janë shfaqur vazhdimisht filma të tjerë që në kontentin e vet kanë pasqyruar elementë e aspekte të jetës së personave LGBT, siç është filmi “Blue is the warmest color”;
- Nga praktika e Kinemasë, rezulton se ka dhe filma të tjerë shfaqja e të cilëve është anuluar, siç është filmi “Era e Jugut”;
- Së fundmi, Kinemaja ka pohuar në mënyrë të përsëritur, se pranon ta shfaqë filmin “Strange World” nëse pala ankuese do ta sponsorizojë atë, fakt i cili prezumon se nuk ka lidhje me tematikën apo grupin e personave që “prek” ai, pra komunitetin LGBT.

Përfundimisht, në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i palës ankuese për diskriminim të komunitetit LGBT, për sa i takon anulimit të shfaqjes së filmit “Strange World”, nga ana e Kinemasë “Millenium” nuk qëndron dhe është i papabazuar në fakte e prova.

Në mungesë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nuk mund të pretendohet për trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të komunitetit LGBT, nga ana e Kinemasë, e për rrjedhojë as për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja b), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, në fushën e të mira dhe shërbimeve, të personave të komunitetit LGBT, nga ana e Kinema “Millenium” Tiranë, për shkak të “*orientimit seksual*” dhe të “*identitetit gjinor*” të tyre, lidhur me anulimin e shfaqjes së filimit “Strange World”, me datë 24.11.2022.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaqe: Orientimi seksual, identiteti gjinor